



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Datën 30-07-2025			
Nr. i Organi Org. Broj	Nr. i Broj	Shitja e Projeq	Vlera Vrednost
001-	110/03-		1088



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.07.2025, miraton këtë:

V E N D I M

vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga një projekt në tjetrin

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e të hyrave vetanake nga një projekt në tjetrin.

- Asfaltimi i Rrugës Sllatinë-Viti, 21/657/17533/50759/012 shuma 10.000 euro;
- Ndërtimi i urave Jezava, Gelbushi, Podgorc-Lubishtë, Budrikë dhe Skifteraj 21/657/17533/55027/012, shuma 10.000 euro;
- Ndërtimi i palestrave sportive shkollore 21/657/17533/56332/012, shuma 20.000 euro;
- Ndërtimi i parkut të qytetit në Viti, 21/657/17533/56367/0112, shuma 10.000 euro;
- Ndërtimi i qytetit intelegjent-mençur-ndërtimi i pritoreve, tabelave informuese, ulëse betoni, kontenjer nëntoksor, instalimi i kamerave të qytetit, 21/657/17533/56371/0112, shuma 10.000 euro;
- Programi për efikasitet të energjisë dhe burimet e ripërtrishme të energjisë, pompa termike, objekte arsimore, shëndetësore dhe komunale në Viti, 21/657/17533/56375/0112, shuma 15.000 euro.

Neni 2

Këto të hyra vetanake bartën në projektin Partecipim i projekteve me donator, kodi 90552.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

ARSYETIM

Arsyeja e bartjes së këtyre të hyrave vetanake nga një projekt në tjetrin është se, Komuna e Vitisë ka marrëveshje me LOGOS-in, dhe me bartjen e këtyre të hyrave vetanake, Komuna e Vitisë participon në investime kapitale në Komunë të Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

